

KONTRATE SHERBIMI

“Për shërbimin e kontrollit fillestar dhe periodik të matësve të energjisë elektrike”

Në Tiranë, sot më datë ____/2011, lidhet kjo Kontratë Shërbimi për kontrollin fillestar e periodik të matësve (Kontrata) nga dhe ndërmjet:

1. Shoqërisë “_____” sh.a./sh.p.k., person juridik i së drejtës shqiptare, me seli në _____, regjistruar me Vendimin Nr. _____, datë __/__/__ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS _____, i përfaqësuar nga administratori/person i autorizuar Z/Zj. _____, këtu e më poshtë i quajtur “Kontraktuesi” ose “_____”

dhe,

2. Shoqërisë “_____” sh.p.k., person juridik i së drejtës shqiptare, me seli në _____, regjistruar me Vendimin Nr. _____, datë __/__/__ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS _____, i përfaqësuar nga administratori Z. _____, këtu e më poshtë i quajtur “Kontraktori”,

Të cilët, gjithashtu, këtu dhe më poshtë mund të quhen bashkarisht si palët ose veç e veç si pala.

Palët me cilësitë që u njeh ligji në Republikën e Shqipërisë dhe vullnet të lirë, bien dakord të hartojnë, nënshkruajnë dhe respektojnë këtë marrëveshje si më poshtë vijon:

I. BAZA LIGJORE

1. Palët hartojnë këtë marrëveshje dhe anekset, bazuar në Ligjin Nr.9072, datë 22/05/2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, Kodin e Matjes, Ligjin Nr.9875, date 14/02/2008 “Për metrologjinë” i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon përkatësisht marrëdhëniet në Republikën e Shqipërisë.

II. TE PËRGJITHSHME

- 2.1. Kjo Kontratë do të përdoret për të siguruar dhe rregulluar marrëdhëniet ndërmjet palëve për realizimin e shërbimit të kontrollit fillestar e periodik të matësve të energjisë

elektrike, këtu e më poshtë të quajtura në tërësi Shërbimet e Kontrollit, të cilësuar në anekset e kësaj Kontrate.

- 2.2. Kontrata dhe anekset e saj përcakton kushtet teknike dhe financiare të realizimit të shërbimeve të kontrollit dhe përbën të gjithë marrëveshjen midis palëve.
- 2.3. Kontrata përmban pjesën e përgjithshme dhe anekset e listuara në aneksin A 1-Përmbajtja. Përkufizimet e termave dhe konceptet e përdorura në këtë kontratë paraqiten në aneksin A2-Përkufizime. Anekset janë pjesë përbërëse integrale e Kontratës. Pjesa e përgjithshme dhe Anekset nënshkruhen dhe vulojnë njëkohësisht nga palët.
- 2.4. Në asnjë rast anekset nuk mund të përmbajnë dispozita të cilat shkojnë në kundërshtim me dispozitat e kontratës të vendosura në pjesën e përgjithshme të saj, përveç se kur ky ndryshim shoqërohet shprehimisht me shkrim për shfuqizim të dispozitës respektive në pjesën e përgjithshme të kontratës.
- 2.5. Kjo Kontratë përbën të vetmen marrëveshje midis palëve dhe zëvendëson çdo kontratë apo marrëveshje të mëparshme mes tyre.
- 2.6. Në interpretimin e Kontratës, anekseve bashkangjitur ose shtesave që janë pjesë e saj, termat në vijim do të kenë kuptimin e përkufizimeve sipas Ligjit Nr.9072, datë 22/05/2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, Kodit të Matjes, Ligjit Nr.9875, datë 14/02/2008 "Për metrologjinë" i ndryshuar, akteve të dala në zbatim të tyre dhe përkufizimeve sipas Aneksit 2 të kësaj kontrate.

III. OBJEKTI I KONTRATES

3.1 Objekt i kësaj kontrate të realizuar midis palëve konsiston në:

- verifikimin e **saktësisë** së aparateve matëse të energjisë dhe kolaudimin e tyre, në momentin e vendosjes për herë të parë në treg ose para përdorimit (instalimit) për herë të parë tek konsumatori;
- inspektimin periodik për verifikimin e saktësisë së aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike,
- verifikimin, kolaudimin, vulosjen, si dhe mirëmbajtjen e matësve të energjisë elektrike;

- kontrollin e saktësisë , kolaudimin e paisjen me certifikate të matësve të energjisë që vendosen për herë të parë në përdorim.
- kontrollin, kolaudimin periodik të matësve të energjisë, në periudha kohore të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, kodi i matjes dhe/ose kërkesat teknike të përcaktuara nga prodhuesi.
- Kontrollin, kolaudimin e matësve të energjisë sa herë që kërkohet nga kontraktuesi ose konsumatori(subjekti fizik ose juridik);
- Teste ,rregulloje ,te rregjistroje dhe pais me certifikate të gjithë matësve të rinj përpara përdorimit (insalimit).
- Blllokimin e matësve të energjisë që konstatohen të dëmtuar apo që janë jashtë performancës e nuk punojnë në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Kodin e Matjes dhe nga DPM duke vendosur pulle blllokimi dhe njoftimin e shpërndaresit për ndërrimin e tyre;
- Marrja në dorëzim dhe klasifikimi i dokumentacionit sipas ndarjeve gjeografike;
- Dixhitalizimi i informacionit të fotografuar(skanuar) në një database (Data entry) sipas standardeve të DPM;
- Rifreskimi i informacionit të dixhitalizuar me adresarin e ri;
- Krijimi i hartave gjeografike zonale sipas të dhënave të aparateve matës të energjisë dhe abonentëve;
- Unifikimi i hartave zonale të shpërndarjes së matësve të energjisë në shkallë kombëtare (GIS);
- Krijimi i database elektronik (Sistemi i Rregjistrimit të Matësve) e arshives fizike të aparateve matës të energjisë për ruajtjen e të dhënave sipas kodit të matjes;
- Teste rregjistrimit dhe të dhënave për të gjithë sistemin e matjes që lidhet me kalibrimin si edhe me datat dhe rezultatet e çdo testi, apo rregullimet e të dhënave informacionin që kërkohet në një periudhë 10 vjetësh për çdo pik matjeje.
- Instalimi i sistemit elektronik për mundësimin e marrjes së të dhënave nga database e harta në kohë reale nga ERE, DPM e Kontraktuesi.

3.2 Kontrolli, verifikimi dhe kolaudimi i instrumentave matës do të kryhet konform metodikave dhe standardeve të mëposhtëm dhe specifikimeve të përcaktuara në Aneksin 4:

(i) Metodika “Kërkesa metrologjike për njehsorët induktivë të energjisë elektrike (format i adaptuar i instruksionit për kontrollin , kolaudimin dhe remontin e kontaktorëve elektrikë)”

(ii) Standarti SSH EN 62053-11:2003 “Pajisje matëse elektrike e rrymës alternative – Kërkesa të veçanta”,Pjesa 11: “Matësit elektromekanik për energjinë aktive (klasa 0.5;1 dhe 2)”

(iii) Standarti SSH EN 62053-21:2003 “Pajisje matëse të rrymës alternative – Kërkesa të veçanta –pjesa 21:”Matësit elektronik të energjisë aktive (klasa 1 dhe 2)

(iv) Direktiva evropiane e instrumentave matës – MID, aneksi III

3.3 Metoda e kontrollit të kontatorëve (matësve) është ajo e krahasimit të energjisë së matur nga kontatori në testim me atë të kesaj energjie të matur në kontatorin kampion(standart electric meter).

3.4 Kontrolli, verifikimi, kolaudimi, zëvendësimi dhe vulosja e instrumentave matës nga Kontraktori kryhet për:

- a) Kontatorë elektrikë një fazor të klasës së saktësisë deri 0.5, me sistem matje elektro-mekanik (induktiv) dhe elektronik, të rrymës alternative;
- b) Kontatorë elektrikë tre fazorë të klasës së saktësisë deri 0.5, me sistem matje elektro-mekanik (induktiv) dhe elektronik, të rrymës alternative, me tre dhe katër përcjellës.

3.5 Inspektimi periodik për verifikimin e saktësisë së aparateve matëse dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike do të bëhet në përputhje me kriteret e Kodit të Matjes të miratuar nga ERE deri në miratimin e kalendarit të inspektimit nga Këshilli i Ministrave.

IV. TË DREJTAT E DETYRIMET E PALEVE

4.1 Palët do të bashkëpunojnë dhe Kontraktori do të ofrojë shërbimet e kontrollit e të inspektimit, të paraqitura në objektin e kontratës dhe në anekset përkatëse të saj në përputhje edhe me specifikimet dhe procedurat përkatëse që përcaktohen sipas kësaj kontrate.

4.2 Secila palë do të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke u bazuar në parimin e korrektesës në përmbushjen e detyrimeve respektive.

4.3 Palët do të bashkërendojnë programin e punës për realizimin praktik të objektit të Kontratës duke ngritur strukturat përkatëse për koordinim, bashkërendim e për organizimin e punës. Palët mbajnë përgjegjësi reciproke për zbatimin në kohë të këtij programi.

4.4 Kontraktuesi garanton kushtet normale organizative e teknike për punë të grupeve të punës për dorëzimin e dokumentacionit të plotë të verifikimit, kolaudit e vulosjes së matësve elektrikë si dhe do të japë informacion të plotë për gjendjen e tyre teknike në zbatim të këtij programi.

- 4.5 Kontraktuesi garanton kushtet normale organizative e teknike për punë të grupeve të punës në terren për verifikimin, kolaudimin e vulosjen e pajisjeve matëse elektrike.
- 4.6 Kontraktuesi brenda 10 ditëve pune nga nënshkrimi i kontratës krijon strukturën e nevojshme për koordinimin e veprimtarisë me Kontraktori dhe prezencën e tyre në zbatimin e ligjit e të planit të punës, këqyrjen në terren, hartimin e procesverbaleve të domosdoshme në terren dhe krijimin e kushteve tekniko-organizative për verifikimin, kolaudimin e vulosjen e matësve elektrikë. Për realizimin e shërbimeve të kontrollit, Kontraktuesi ka detyrimin që, në përputhje me planin e organizimit e të kontrollit, të kryejë paraprakisht lajmërimin e konsumatorëve, matësit e të cilëve do të kontrollohen.
- 4.7 Kontraktori është përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit përkatës për kryerjen e verifikimit, kolaudimin e vulosjen e pajisjeve matëse elektrike sipas standardit dhe kritereve të Kodit të Matjes.
- 4.8 Kontraktuesi ka detyrimin t'i sigurojë Kontraktorit akses të plotë në vendet ku do të ushtrohen shërbimet objekt kontrate si dhe do t'i sigurojë çdo informacion në lidhje me matësit dhe pajisjet e matjes sipas kërkesave të kontratës, Kodit të Matjes, kërkesave të DPM dhe Legjislacionit në Fuqi.
- 4.9 Kontraktori duhet t'i kryejë dhe përmbushë Shërbimet dhe detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficientë dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore dhe me karakteristikat teknike specifike të matësve të energjisë.
- 4.10 Marrja në dorëzim e dokumentacionit dhe kryerja e shërbimeve nga Kontraktori do të evidentohet nëpërmjet procesverbaleve të hartuara me Kontraktuesin. Kontraktori ka detyrimin të informojë periodikisht DPM për kontrollin periodik për verifikimin e saktësisë së matësve dhe të sistemit të matjes së energjisë elektrike nëpërmjet relacioneve.
- 4.11 Në marrëdhëniet me të tretët, që mund të lindin për shkak të realizimit të kësaj kontrate, palët mund të bazohen dhe përdorin këtë kontratë duke shtuar si aneks vetëm pjesën përkatëse me termat e veçantë, ose mund të lidhin marrëveshje të veçanta mes tyre, por pa shkelur detyrimet dhe parimet e kësaj kontrate.

- 4.12 Secila palë merr përsipër që të mos bëjë ndryshime në rrjet, ose çdo pajisje që përfshihet në të, ose çdo komande ose protokoll që ruhet, ndryshim i cili mund të ndikojë ose dëmtojë funksionimin e pajisjeve të palës tjetër.
- 4.13 Në rast se ndonjëra nga palët dëshiron të bëjë ndryshime apo të kërkojë shërbime të veçanta veç atyre të parashikuara në këtë kontratë, ajo duhet të njoftojë palën tjetër. Mënyra e njoftimit përcaktohet dhe është pjesë e kontratës në anekset e saj. Për ndryshimet që do të bëhen, palët diskutojnë dhe procedojnë pasi të nënshkruajnë mes tyre akt-marrëveshje ose proces verbal për këtë qëllim.
- 4.14 Palët do të regjistrojnë të dhënat mbi shërbimet e kontrollit të kryera nga Kontraktori në atë masë të përcaktuar në kontratë. Informacioni i ruajtur nga secila palë do t'i jepet palës tjetër, së cilës i është dhënë e drejta ta përdorë këtë informacion në atë masë të përcaktuar në këtë kontratë. Kontraktori do të krijojë arkivën fizike dhe elektronike sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.
- 4.15 Palët marrin përsipër që, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate, të bashkëpunojnë për këtë qëllim.
- 4.16 Kontraktori ka detyrimin që:
- të njoftojë menjëherë Kontraktuesin për çdo situatë parregullsie të konstatuar nga autoritetet shtetërore të kontrollit, si dhe për çdo pezullim apo heqje të lejeve/licencave, autorizimeve etj., që kanë të bëjnë me shërbimet e kontrollit;
 - të njoftojë menjëherë Kontraktuesin për procedim ligjor që ka për objekt shërbimet e kontrollit, përjashtuar ato të përcaktuara me ligj;
 - të mbajë të informuar Kontraktorin për zhvillimet në situatat dhe procedimet e lartpërmendura.
- 4.17 Në lidhje me sa përshkruar në paragrafin 4.9, Kontraktori mund të kryejë shërbime shtesë dhe, në rast se është e nevojshme, të marrë masa për pezullimin dhe/ose ndërprerjen e shërbimeve të kontrollit, në varësi të shkallës së rëndësisë dhe impaktit të ngjarjes në fjalë.
- 4.18 Kontraktuesi ka detyrim që:
- Sipas grafikut të miratuar të sjell në laboratorin e autorizuar kontatorët e energjisë dhe të bëjë dorezimin e dokumentacionit të tyre për verifikim, kolaudim e vulosjen e tyre.
 - Të verifikojë ekzistencën e çertifikimit, testimit dhe vulosjes së mosetërisë e makinerisë të matesit e sistemit të matjes nga laboratori i autorizuar para kryerjes së lidhjeve të reja.

- 4.19 Laboratori i autorizuar kryen verifikimin , kolaudimin dhe vulosjen e makinerisë matës të matësve të energjisë elektrike që rezultojnë në rregull. Për matësat e energjisë elektrike që rezultojnë nga verifikim – kolaudimi të parregullt nuk bëhet vulosje e makinerisë të tyre.
- 4.20 Laboratori përgatit dhe fut të dhënat e rezultateve të verifikimit në arshivë dhe përgatiti dokumentin e dorëzimit sipas formatit të bashkërenditur ndërmjet palëve.

V. SUBJEKTI I STANDARDIT TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT

- 5.1 Vetëm pajisjet e specifikuara në objektin e kontratës janë subjekt i vlerësimit dhe kontrollit nga ana e Kontraktorit me qëllim verifikimin dhe vulosjen e instrumentave.
- 5.2 Shërbimet e Kontraktorit nuk shtrihen për produktet apo shërbimet e tjera të ofruara nga Kontraktuesi, prandaj nuk mund të përdoret ose të trajtohet në mënyrë të tillë që të çojë palët e treta që të besojnë se edhe këto produkte apo shërbime janë të certifikuara.
- 5.3 Shërbimet do të kryhen nga Kontraktori mbi bazën e dokumentit referim standard shprehimisht e treguar nga Kontraktuesi në zbatim të kësaj kontrate dhe detyrimeve ligjore.
- 5.4 Përveç nëse kërkohet ndryshe me dokumentin standard reference, Kontraktori do të kryejë kontrollet e saj për të vlerësuar konformitetin e pajisjeve matëse të Kontraktuesit me anë të kontrolleve të kryera periodikisht sipas specifikimeve të dhëna në Aneksin __.

VI. RESPEKTIMI I KRITËVE LIGJORE

Gjatë gjithë vlefshmërinë të afatit të kontrollit të realizuar nga Kontraktori, Kontraktuesi merr përsipër të jenë në përputhje me kërkesat teknike të pajisjeve dhe ato ligjorisht të detyrueshme, të tilla si ligjet ndërkombëtare, kombëtare apo vendore, rregulloret, etj, të aplikueshme për produktet e saj, shërbimet ose personelit. Verifikimi i Kontraktorit ka të bëjë vetëm me konstatimin e konformitetit të matësit me standardet e matjes dhe prandaj nuk kërkohet që Kontraktori të nxjerrë një deklaratë/certifikatë apo të verifikojë respektimin nga Kontraktuesi të kërkesave të akteve ligjore. Në këtë rast Kontraktuesi është përgjegjësi i vetëm për konformitetin e ligjshmërisë dhe Kontraktori nuk ka asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrime për garanci.

VII. DHENIA E INFORMACIONIT

- 7.1 Kontraktuesi ka detyrimin t'i sigurojë e t'i vendosë në dispozicion Kontraktorit asistencën dhe të gjithë dokumentacionin dhe regjistrimet që kanë të bëjnë me matësit e energjisë të klasës së saktësisë 0.5 një fazorë dhe tre fazorë të përdorur prej saj. Gjithashtu ka detyrimin t'i sigurojë akses të plotë e të sigurt në të gjitha zonat dhe ambientet ku duhet të kryhen shërbimet e kontrollit.
- 7.2 Të gjitha aktet (dokumenta, letra, komunikime, regjistrime etj.) që kanë të bëjnë me shërbimet objekt i kësaj kontrate konsiderohen konfidenciale. Rregullimi i konfidencialitetit bëhet sipas parashikimeve të nenit XVIII të kësaj kontrate.

VIII. KONTROLLI DHE SIGURIA NË PUNË

- 8.1 Në përputhje me legjislacionin për sigurinë në punë dhe parandalimin e aksidenteve, Kontraktuesi ka detyrimin të sigurojë Kontraktorin me informacionin e plotë e të detajuar në lidhje me risqet specifike ekzistues në vendet ku do të ushtrohet kontrolli nga punonjësit e kompanive që realizojnë shërbimin e kontrollit.
- 8.2 Kontraktuesi gjithashtu ka detyrimin të caktojë një punonjës të tij specialist për këtë qëllim, bashkëpunimin dhe koordinimin për sa i përket zbatimit të masave për shmangien e rrezikut në punë dhe parandalimin e aksidenteve që ndikojnë në punën e kompanive.

IX. MODIFIKIMI I KUSHTEVE TË SHËRBIMEVE

- 9.1 Kontraktori mund të ndryshojë ose të modifikojë procedurat e shërbimeve të saj, duke ndjekur referencat e standardeve apo modifikimet e kërkuara nga legjislacioni ose organet akredituese. Në këto raste Kontraktori do të njoftojë paraprakisht Kontraktuesin për këto ndryshime.
- 9.2 Të gjitha kostot për rishikimin e procedurave ose kontrollet në ambientet ku ndodhen matësit të rrjedhura nga këto ndryshime ligjore apo modifikime rregullatore janë në ngarkim të Kontraktuesit.

X. E DREJTA E PËRDORIMIT TË RESURSEVE TË JASHTME

- 10.1 Kontraktori për realizimin e shërbimeve mund të përdorë si punonjësit e vet, ashtu edhe personel të jashtëm të kualifikuar për të përmbushur shërbimet e kontraktuara.
- 10.2 Këta persona duhet të respektojnë të gjitha detyrimet e Kontraktori, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me konfidencialitetin.

XI. PËRGJEGJËSIA CIVILE DHE KONTRAKTUALE

- 11.1 Kontraktori në zbatim të shërbimeve objekt kontrate nuk është përgjegjëse për mos përmbushje, mos përshtatje ose dëme të shkaktuara apo gjithsesi të lidhura me prodhuesin e matësit. Gjithashtu, verifikimi dhe kolaudimi i matësit nuk e çliron Kontraktuesin nga përmbushja e detyrimeve ligjore të lidhura me produktet, proceset e punës dhe shërbimet që ofron dhe as nga detyrimet kontraktore me të tretët.
- 11.2 Ndryshime eventuale organizative apo strukturore të kryera nga Kontraktuesi për të realizuar këtë kontratë janë në ngarkim të tij pa asnjë detyrim nga ana e Kontraktorit.
- 11.3 Në çdo rast, Kontraktuesi merr përsipër qysh në këtë moment të çlirojë Kontraktori nga çdo kërkesë që atij mund t'i kundrejtohet nga të tretë në referim të shërbimeve që i ofron Kontraktuesit, si dhe do ta mbajë atë të pacenuar nga çdo dëmshpërblim apo pagesë që mund të paguhet në lidhje shërbimet objekt kontrate.
- 11.4 Kontraktuesi deklaron dhe njeh se shërbimet e Kontraktorit do të realizohen ekskluzivisht në përmbushje të të gjitha kushteve ligjore në çdo mangësi në pajisjet matëse pas realizimit të shërbimit nga kontraktori e rrjedhur nga mungesa apo mangësi të prodhuesit apo veprime të Kontraktuesit ose të tretëve ndaj pajisjeve matëse, nuk sjellin asnjë përgjegjësi mbi Kontraktorin dhe as janë mos përmbushje nga ana e kësaj të fundit.
- 11.5 Kontraktuesi ka detyrimin dhe merr përsipër që të mos modifikojë e dëmtojë në asnjë rast e për asnjë shkak vulat e vendosura nga Kontraktori dhe raportet e provës dhe as të bëjë kopje të tyre.

XII. TARIFAT – PAGESA PËR SHËRBIMET.

12.1 TARIFAT – TË PËRGJITHSHME:

- 12.1.1 Kontraktuesi do të paguajë Kontraktorin për të gjitha shërbimet e realizuara prej tij që parashikon kontratat dhe anekset e saj.

- 12.1.2 Kushtet e pagesës sipas kontratës do të zbatohen duke filluar nga dita e parë e në të cilën ka hyrë në fuqi kontrata.
- 12.1.3 Tarifat e shërbimit do të jenë ato të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave e të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kurse për shërbime, për të cilat nuk janë përcaktuar tarifat në këtë udhëzim, do të aplikohen tarifatat që përdor DPM për shërbime të njëjta ose të ngjashme në rast se palët nuk përcaktojnë tarifa të tjera në marrëveshje midis tyre.
- 12.1.4 Kontraktuesi njeh të drejtën e Kontraktorit të aplikojë ndryshime të njëanshme të tarifave të shërbimit të cilat janë të lidhura me kostot e tij të realizimit të shërbimeve; këto ndryshime megjithatë do të aplikohen ekskluzivisht për shërbimet pasardhese nga data e ndryshimit. Ndryshimi i tarifave duhet t'i komunikohet Kontraktuesit nga Kontraktori jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë përpara aplikimit të tyre.
- 12.1.5 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 12.1.6 Brenda 5(pese) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate, Kontraktuesi do të ngurtësojë në një nga bankat me veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, një sasi lekësh të barabartë me 75 % të vlerës së shërbimit të parë, që do të kryhet nga Kontraktori. Pagesa e parë e barabartë me vlerën 25% të vlerës së çdo shërbimi, i paguhet Kontraktorit nga Kontraktuesi brenda 5 ditëve pune, nga dita kur Kontraktori ka rënë dakort me shkrim për kryerjen e shërbimit të kërkuar. Vlerë do të përcaktohet mbi bazën e planit të shërbimeve që palët do të përcaktojnë sipas Aneksit __. Kjo vlerë do të kalojë në llogari të Kontraktorit, në masën e vlerës së papaguar nga Kontraktuesi për punën e bërë nga Kontraktori, nëqoftëse detyrimi për punën e bërë nuk është paguar brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë. Kalimi bëhet nëqoftëse kjo vonesë konfirmohet nga DPM.

12.2. FATURIMI – PAGESA.

- 12.2.1 Pagesa e shërbimeve do të kryhet kundrejt faturimit (sipas situacioneve) të tyre nga ana e Kontraktorit dhe jo më vonë se 5 (pese) ditë nga data e lëshimit të faturës. Për pagesa të këtij afati do të aplikohet një penaltet vonesë i barabartë me normën e interesit bankar të

shpallur nga Banka e Shqipërisë të ditës kur kryhet pagesa plus 2 % që i shtohen vlerës së faturës për t'u paguar.

- 12.2.2 Kontraktuesi do të paguajë vlerën e shpenzimeve të përballura nga Kontraktori në rastet kur shërbimi nuk është konkretizuar për shkak të të metave të Kontraktuesit
- 12.2.3 Termat e faturimit dhe të pagesës përcaktohen në mënyrë më specifike në aneksin A5 – FATURIMI.
- 12.2.4 Në rast të mos kryerjes qoftë edhe pjesërisht të pagesës, Kontraktori ka të drejtën e pezullimit të ofrimit të shërbimeve deri në kryerjen e saj të plotë nga Kontraktuesi, pa patur asnjë lloj përgjegjësie ndaj Kontraktuesit dhe/ose të tretëve.

XIII. KËRKESA TEKNIKE DHE TË TJERA.

KËRKESA TEKNIKE:

- 13.1.1 Palët janë përgjegjëse që kushtet e pajisjeve dhe shërbimet përkatëse të tyre të jenë në përputhje me specifikimet teknike për të cilat kanë rënë dakord në aneksin A3 – ÇËSHTJE TEKNIKE, si dhe me specifikimet teknike, që janë gjithashtu të zbatueshme si rrjedhojë e kushteve ligjore dhe akteve ligjore të nxjerra nga DPM dhe ERE për këtë qëllim. Kjo kontratë është në përputhje me standartin e cilësisë ISO/IEC 17025.
- 13.1.2 Paisjet matese që do të sigurohen nga të gjithë Pjesëmarrësit e Tregut detyrohen nga legjislacioni në fuqi, të jenë të regjistruara në Sistemin e Rregjistrimit të Matesave (SRM) dhe në përputhje me termat e Kodit të Matjes si dhe në përputhje me ligjin Nr.8996 datë 30.01.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matese (metrologjine)” të përshkruara në ISO/IEC 17025:2005.
- 13.1.3 Për kryerjen e verifikimit, testimit kolaudit dhe ekspertizës tekniko - ligjore do të përdoren laboratore stacionare e portative të certifikuara sipas Legjislacionit në fuqi dhe standartet përkatëse dhe neqoftëse gjykohet e nevojshme (sipas një marrëveshje midis paleve) mund të përdoren paisjet dhe kushtet që ofron një laborator i autorizuar sipas ligjit Nr. 8996 datë 30.01.2003. “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matese (metrologjine)”.

3-Proceset e punës të verifikimit të kontaktoreve të energjisë elektrike në laborator:

- Marrja në dorezim e matesave nga personat e autorizuar nga Kontraktuesi, në laboratorin e autorizuar
- Hedhja në kompjuter e të dhënave të matesave të marra në dorezim;

- Kontrolli i jashtëm i cdo matesi:
- Pastrimi i tyre
- C'vulosja e matesave dhe vendosja (lidhja) në stende të tyre matesave ;
- Kontrolli teknik,
- Kontrolli i izolacioni,
- Kolaudimi
- Ngrohje e matesave sipas klases së saktësisë,
- Kontrolli për vetelevizje:
- Kontrolli për ndjeshmëri:
- Kontrolli nën ngarkesë me 4 ng $\cos \phi$ dhe Kontrolli për 2 ng për $\cos \phi = 0.5$
- Ngarkesë 10 %
- Ngarkesë 20%
- Ngarkesë 50 %
- Ngarkesë 100 %
- Vendosja e kapakut të mosrrethës
- Vulosja e makinerisë të kontaktoreve
- Heqja nga stenda,
- Përgatitja dhe hedhja e të dhënave në data base
- Paketimi dhe magazinimi i matesave të kontrolluar
- Dhenia e komandave të ndryshme gjatë nxjerrje së gabimeve
- Plotesimi i fletanalizave
- Dorezimi i matesave të kontrolluar:

4- Për kryerjen e inspektimit të kontrollit periodik të Kontaktoreve (matesave elektrik) duhet të përdoren matesa etalon portabel. Matesat etalon portabel të kontrollit do të përdoren për kontrollin ose testimin periodik të paisjeve të matjes së energjisë elektrike të cilat duhet të testohen në përputhje me rishikimin e fundit të standarteve të IEC për matesat e Energjisë Elektrike Kodin e matjes. Për këtë qëllim do të kryhen testet minimale si,

a- Formën e karakteristikës së ngarkesës.

b- Përcaktimin e ndjeshmërisë.

c- Mungesën e vetelevizjes

Terminologjia e përdorur në Manualin e Cilësisë dhe dokumentet e tjera lidhur me të janë konform

a- EN ISO 9001 "Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, Kërkesat

b- "Fjalori Ndërkombëtar i Metrologjisë, Konceptet Themelore dhe të Përgjithshme shoqëruar me termat "

Botimi i tretë, drafti final 01.08.2006

c- "Udhëzues për shprehjen e pasigurisë " ISO 1995

13.2. **PLANIFIKIMI.**

13.2.1 Palët do të hartojnë planin e realizimit të objektit të kontratës në përputhje me kriteret e përcaktuara nga DPM për procedurat e verifikimit dhe kalendarin e kalimit të dokumentacionit si dhe të realizimit të shërbimeve.

13.2.2 Kushtet e planifikimit të realizimit të shërbimit dhe kalendarin përcaktohen në mënyrë të detajuar në Aneksin A4 – ÇËSHTJE TEKNIKE.

XIV. **INSTALIMI, FUNKSIONIMI DHE MIREMBAJTJA.**

Secila palë është përgjegjëse për instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e aparateve matëse të energjisë elektrike. Palët hartojnë dhe nënshkruajnë dokumentacionin përkatës për këtë qëllim dhe Kontraktori njofton periodikisht DPM për inspektimin periodik dhe çdo ndryshim të dokumentacionit.

XV. **MBROJTJA E RRJETEVE DHE SIGURIA.**

Palët parashikojnë dhe rregullojnë në këtë kontratë mbrojtjen dhe sigurinë e pajisjeve të matjes dhe në ushtrimin e shërbimit të kontrollit sipas aneksit A5.

XVI. **TE DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE.**

16.1 Kontrata nuk i jep palëve ndonjë të drejtë pronësie intelektuale që i përket palës tjetër për efekte të rregullimit të marrëdhënieve që lindin dhe zhvillohen për shkak të saj.

16.2 Kur pronësia intelektuale zhvillohet në lidhje me zbatimin e kontratës, atëherë në mungesë të ndonjë marrëveshje tjetër midis palëve, pronësia intelektuale do t'i mbetet palës e cila e zhvilloi atë, gjithmonë me kusht që sipas kësaj marrëveshje, pala tjetër duhet të ketë një licencë të shkruar që të përdorë pronësinë intelektuale pa pagesë me qëllim zbatimin e kontratës.

XVII. FORCA MADHORE.

- 17.1 Asnjëra nga palët nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë shkelje të marrëveshjes në qoftë se ajo shkaktohet nga ndonjë fatkeqësi natyrore, Cuname, termete, revolucion, zjarri, epidemitë, shtrëngime të karantinës, gjendje të jashtëzakonshme, greva të përgjithshme apo çdo shkak tjetër që ligji i barazon me forcat madhore.
- 17.2 Pala e prekur nga një ngjarje e tillë do të njoftojë menjëherë palën tjetër për shkallën dhe kohëzgjatjen përafërsisht të kësaj pamundësie për të përmbushur detyrimet e saj dhe të paraqesë brenda 20 ditëve nga njoftimi i dhënë dokumenta të vërtetuara nga organet kompetente në vend.
- 17.3 Me pushimin e vonesave ose të humbjeve që kanë rezultuar nga kjo ngjarje, pala e prekur do të njoftojë palën tjetër për këtë ndërprerje.
- 17.4 Nëqoftëse si rezultat i kësaj ngjarje, përmbushja nga ndonjëra palë e detyrimeve të saj kontraktore, preket vetëm pjesërisht, atëherë kjo palë mbetet përgjegjëse për realizimin e detyrimeve të pa prekura.

XVIII. KONFIDENCIALITETI.

- 18.1 Informacionet, korrespondencat dhe çdo dokument tjetër i shkëmbyer mes palëve për shkak të kontratës dhe marrëdhënieve që lindin ose rregullohen prej saj, do të cilësohet konfidencial dhe do t'i nënshtrohet prej palëve trajtimit ligjor si material konfidencial dhe nuk do të përdoret përtej qëllimit të tij.
- 18.2 Aksesimi dhe konsultimi i dokumentave relative me shërbimet e kontrollit është i rezervuar për funksionet e përfshira në dhe nuk mund t'u bëhen të njohura të tretëve përveç se atyre funksioneve të përfshira në procesin e shërbimeve të kontrollit dhe palëve.
- 18.3 Përjashtohen nga rregulli i mësipërm informacioni ose çdo dokument tjetër:
- që është siguruar në mënyrë të ligjshme nga të tretët;
 - që njihet si i ligjshëm për t'u publikuar nga marrësi në ditën e marrjes;
 - që është i lirë në zotërim të publikut.

18.4 Nëse informacione që kanë të bëjnë me Kontraktuesin duhet t'u bëhen të ditura të tretëve për shkak të detyrimeve ligjore, Kontraktori do të informojë Kontraktuesin në një afat të përshtatshëm.

18.5 Për sa përmendet në paragrafët e mësipërm të këtij neni, palët do të vazhdojnë ta respektojnë kontratën deri në 5 (pesë) vjet pas përfundimit ose ndërprerjes së njëanshme të saj.

XIX. AFATI, HYRJA NE FUQI DHE VLEFSHMERIA.

19.1 Kontrata hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme për një periudhë prej tre vjetësh deri më datë __/__/2011 me të drejtë përsëritje.

19.2 Pas mbarimit të këtij afati palët kanë të drejtë dhe duhet të nënshkruajnë një kontratë të re në zbatim të ligjit. Tre muaj përpara mbarimit të kësaj kontrate, palët fillojnë negociatat për rinovimin e saj.

19.3 Brenda afatit të vlefshmërisë së kontratës, palët kanë të drejtë të rinegociojnë dhe modifikojnë, terma të veçantë por jo në tërësi kontratën, me kusht që këto ndryshime të mos çojnë në pavlefshmëri të pjesshme ose të plotë të saj, për shkaqe të parashikuara në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike", Kodin e Matjes, Ligjin Nr.9875, date 14/02/2008 "Për metrologjinë" i ndryshuar, apo të ndonjë ligji tjetër që, sipas legjislacionit shqiptar, mund të ketë fuqi mbi kontratën.

19.4 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, dhe që nuk shpreh faktin që palët reciprokisht kanë rënë dakord për ndryshimin dhe datën e saj.

19.5 Çdo heqje dore nga të drejtat, kompetencat ose rregullimet që mund të bëhen nga palët në pajtim me kontratën bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën për të cilën kjo kryhet.

XX. PERFUNDIMI, NDERPRERJA E KONTRATËS.

20.1 Kontrata përfundon nëse:

- plotësohet afati i vlefshmërisë i parashikuar ne nenin XIX;

- ndonjëra nga palët njofton 60 ditë përpara ndërprerjen e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme për arsye të parashikuara në këtë marrëveshje;
 - ndonjëra nga palët ose bashkarisht mbyllin aktivitetin para afatit me vendim gjykatë për arsye të parashikuara në legjislacionin shqiptar.
- 20.2 Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të ndërpresë në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën, përveç se kur ky fakt rrjedh si pasojë e një vendimi të formës së prerë të gjykatës, ose për arsye të parashikuara në këtë kontratë.
- 20.3 Palët mund të ndërpresin në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme kontratën vetëm kur njëra nga palët:
- Nuk kryen pagesën brenda afateve të parashikuara në këtë kontratë;
 - shkon drejt likuidimit ose është deklaruar në falimentim;
 - Nuk respekton dhe/ose nuk zbaton në mënyrë të përsëritur kushtet e kontratës.
- 20.4 Secila palë është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër 60 dite më parë për ndërprerjen e njëanshme dhe të menjëhershme të kontratës dhe shërbimeve që rrjedhin për shkak të saj.
- 20.5 Përfundimi i marrëveshjes nuk do të çënojë ndonjë dispozitë të kontratës për të cilën shprehimisht parashikohet se do të vazhdojë deri në një afat të caktuar, pavarësisht nga përfundimi ose mbarimi i afatit. Gjithashtu, ky përfundim nuk do të çënojë të drejtat që ka fituar çdo palë.
- XXI. KALIMI TEK TE TRETET.
- 21.1 Kjo kontratë është e detyrueshme dhe e vlefshme vetëm për palët nënshkruese.
- 21.2 Kontrata nuk mund të kalohet, transferohet apo tjetërsohet nga palët përveç se kur ky veprim është i ligjshëm dhe në konformitet me të drejtat civile që shoqërojnë ndryshime që mund të ndodhin në pronësinë e ndonjërës palë apo të dyjave së bashku.
- XXII. PERSONAT E AUTORIZUAR. NJOFTIMET.
- 22.1 Çdo palë mund të emërojë ose autorizojë me shkrim një person/persona ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

- 22.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit/ve të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 22.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim. Në cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.
- 22.4 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që kërkohet ose lind si nevojë e zbatimit të kësaj kontrate, do të jetë me shkrim dhe mund të dërgohet dorazi por me shënimet përkatëse nga sekretaritë ose protokollat e palëve, ose me postë të regjistruar me konfirmim marrje në dorëzim tek selia e palës marrëse ose në adresa të tjera të njoftuara më parë me shkrim nga palët, dhe ky njoftim ose komunikim do të konsiderohet si i dërguar rregullisht kur është marrë në dorëzim nga pala tjetër.

XXIII. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE.

- 23.1 Kjo kontratë dhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të do të rregullohen, interpretohen në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- 23.2 Çdo mosmarrëveshje mes palëve, pretendim ose kundërshtim në lidhje me këtë kontratë, ose çdo shkelje, pretendim ose pavlefshmëria e saj do të zgjidhen me negociatë.
- 23.3 Në rast se mosmarrëveshja ndërmjet palëve, që lidhet me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit të matësve, nuk zgjidhet me negociatë direkte, atëherë palët i drejtohen DPM të vendosë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Vendimi i DPM është detyrues për palët.
- 23.4 Për të gjitha mosmarrëveshjet e tjera që nuk lidhen me zbatimin e procedurave standarde të verifikimit të matësve, nëse Palët nuk arrijnë zgjidhjen me mirëkuptim pas negociatave brenda 30 ditëve, atëherë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

XXIV. DISPOZITA PERFUNDIMTARE.

- 24.1 Asnjë ndryshim në formë modifikimi, heqje apo shtim dispozitash të kësaj kontrate dhe anekseve të saj, nuk do të jetë i vlefshëm nëse më parë nuk është rënë dakord me shkrim për këtë nga palët.

24.2 Kontrata dhe anekset e saj hartohen në gjuhën shqipe, në 2 kopje, nga një për secilën palë.

24.3 Çdo përkthim i kontratës i bërë nga palët për nevoja negocimi ose zbatimi, duhet të noterizohet pranë një noteri publik shqiptar por pa marrë fuqinë dhe cilësinë e një ekzemplari origjinal.

PALËT NENSHKRUESE:

Për Kontraktorin

Per Kontraktuesin

ANEKSI 1: LISTA E ANEKSEVE

Aneksi 1: Përmbajtja (ky aneks)

I.	Baza Ligjore	faqe.....
II.	Te Përgjithshme	faqe.....
III.	Objekti I Kontratës	faqe.....
IV.	Të Drejtat e Detyrimet e Palëve	faqe.....
V.	Subjekti i Standardit të Shërbimit të Kontrollit	faqe.....
VI.	Respektimi i Kritereve Ligjore	faqe.....
VII.	Dhenia e Informacionit	faqe.....
VIII.	Kontrolli dhe Siguria në Punë	faqe.....
IX.	Modifikimi i Kushteve të Shërbimeve	faqe.....
X.	E Drejta e Përdorimit të Resurseve të Jashtme	faqe.....
XI.	Përgjegjësia Civile dhe Kontraktuale	faqe.....
XII.	Tarifat – Pagesa për Shërbimet	faqe.....
XIII.	Kërkesa Teknike dhe të Tjera	faqe.....
XIV.	Instalimi, Funksionimi dhe Mirembajtja	faqe.....
XV.	Mbrojtja e Rrjeteve dhe Siguria	faqe.....
VI.	Te Drejtat e Pronësisë Intelektuale	faqe.....
XVII.	Forca Madhore	faqe.....
XVIII.	Konfidencialiteti	faqe.....
XIX.	Afati, Hyrja ne Fuqi dhe Vlefshmeria	faqe.....
XX.	Perfundimi, Nderprerja e Kontratës	faqe.....
XXI.	Kalimi tek te Tretet	faqe.....
XXII.	Personat e autorizuar. Njoftimet	faqe.....
XXIII.	Ligji i Zbatueshem dhe Zgjidhja e Mosmarreveshjeve	faqe.....
XXIV.	Dispozita Përfundimtare	faqe.....
	Aneksi 2: Përkufizime	faqe.....
	Aneksi 3: Çështjet teknike	faqe.....
	Aneksi 4: Tarifat	faqe.....
	Aneksi 5: Faturimi – Pagesat	faqe.....
	Aneksi 6: Karakteristikat e matësve	faqe.....
	Aneksi 7: Planifikimi dhe procedurat	faqe.....
	Aneksi 8: Shërbimet e Kontrollit	faqe.....
	Aneksi 9: Formularet tip	faqe.....

ANEKSI 2: PERKUFIZIME

Sistemi i Matjes	kupton teresine e paisjeve te matjes: matesin, automatin, transformatoret e matjes, mbrojtjen e matesit dhe izolatorete, qarqet dhe paisjet e ruajtjes te te
Perputhja e matjes	Perputhja e matjes kupton krahasimin e vleres te energjise te rregjistruar ne mates me vleren e energjise totale te kerkuar (e rregjistruar ne distance
Matesi i Kontrollit	quhet matesi i autorizuar dhe i certifikuar per kontrollin e matjes ne raste kur ka debate midis Paleve per tregimet e matjes te matesit te vendosur ne objekt, ose ne rastin e kontrolleve rutine te programuar te matesave.
Instrument mates	është çfarëdo pajisje apo sistem me funksione matëse.
Metrologji	është shkenca e matjeve
Matje	është seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie
Njësi matjeje	është madhësia e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.
Tipi i instrumentit mates	është një seri instrumentesh matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.
Etalon matjeje	është masë matjeje, instrument matës, material referues ose sistem matës i paracaktuar që të përcaktojë, të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose më shumë vlera të një madhësie, për t'i transmetuar ato, me anë të krahasimeve, me instrumente të tjera matëse
Etalon referees	është një etalon që, përgjithësisht, ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.
Ruajtje e etalonit të matjes	janë të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes, brenda kufijve të caktuar
Verifikim i rregullt i një instrumenti mates	është një verifikim i kryer

periodikisht dhe në përputhje me rregullat.

Verifikim jashtë radhe i instrumentit mates është një verifikim i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.

Autorizim është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Certifikim është veprimtaria, nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ose në përputhje me standardet e përcaktuara

Matje zyrtare është një matje e kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar (më poshtë ekzekutues i matjes zyrtare), në përputhje me vendimin administrativ për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organizmave qeveritarë apo të gjykatave.

Verifikim fillestar i instrumenteve matëse është kontrolli i një instrumenti të ri apo të riparuar dhe vërtetimi i përputhjes së instrumentit matës me tipin e miratuar.

Lejim për hedhje në treg ose vënie në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara është leja e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për hedhjen në treg ose vënien në shërbim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat nuk kanë shenjë të verifikimit fillestar.

KME Kodi i Matjes së Energjisë Elektrike i miratuar nga ERE që përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes elektrike.

Ditet e punës kupton çdo ditë përveç të shtunës dhe të dieles dhe ditë-feste zyrtare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Mates (kontaktor) i energjisë elektrike aktive është një pajisje e cila mat energjinë elektrike aktive të konsumuar në një qark.

I = rryma elektrike që kalon nëpërmjet matesit;

I_n = rryma referuese e specifikuar për të cilin është projektuar matesi që funksionon me transformator;

I_{st} = vlera më e ulët e deklaruar e I , për të cilën matesi regjistron energjinë elektrike aktive, për koeficientin e fuqisë një (matesa shumëfazor, me ngarkesë simetrike);

I_{min} = vlera e I , për të cilën gabimi është brenda gabimeve maksimale të lejueshëm (GML-të)
(matesa shumëfazor, me ngarkesë simetrike);

I_{lr} = vlera e I , për të cilën gabimi është brenda GML-së më të vogël që i korrespondon treguesit të klasës së matesit;

I_{max} = vlera maksimale e I për të cilin gabimi shtrihet brenda GML-ve;

U = tensioni i ushqimit në mates;

U_n = tensioni referues, i specifikuar;

f = frekuenca e tensionit ushqyes në mates;

f_n = frekuenca referuese, e specifikuar;

PF = faktori i fuqisë = $\cos\phi$ = cosinusin e ndryshimit në fazë (diferencës fazore) ϕ ndërmjet I dhe U .

Energjia Elektrike Aktive (Wh)

Energjia Elektrike është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe, dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës.

Njesia matëse e saj është Vat-Ore ose shumëfisha të saj:

1000Wh=1kWh

1000kWh=1MWh

1000MWh=1GWh

1000GWh=1TWh=10¹²Wh

Energjia Elektrike Reaktive (VArh)	Energjia Elektrike reaktive eshte integrali i caktuar me kufije kohe i Fuqise reaktive matur ne njesi me volt-amper reaktive–ore ose shumefisha te saj. 1000 VArh = 1 kVArh 1000 kVArh = 1MVArh 1000MVArh=1GVArh 1000GVArh=1TVArh=1012Varh
Fuqia Elektrike Reaktive (VAr)	Fuqia Elektrike Reaktive eshte produkti i tensionit dhe rrymes dhe sinusit te kendit te fazes ndermjet tyre. $Q=(U \times I) \times \sin\varphi$, matet me njesine volt–amper reaktiv(VAr) dhe shumezime standarte 1000 VAr = 1kVAr 1000 kVAr =1MVAr 1000MVAr=1GVAr 1000GVAr=1TVAr=1012Var.
Fuqia Elektrike Aktive (W)	Fuqia Elektrike eshte produkti i tensionit dhe rrymes dhe kosinusit te kendit ndermjet tyre. $P=(U \times I) \times \cos\varphi$ Matet me njesine Vat (W) ose shumezime standarte: 1000W=1kW 1000kW=1MW 1000MW=1GW 1000GW=1TW=1012W
Çertifikim	kuptohet veprimtaria nepermjet se ciles nje pale e trete dhe e pavarur deshmon zyrtarisht se nje produkt, proces ose sherbim eshte ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne udhezimet metodike te Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise dhe Kalibrimit ose ne Standarte.
Persona	qe kryejne aktivite te licensuara ne Sistemin elektroenergjitik si Gjenerues, OSSH, Konsumator i Kualifikuar, furnizues dhe ndonje person tjeter ligjor qe perfiton nga sherbimet e sistemit te Transmetimit.
Periudha e marreveshjes	kupton kohen gjate te ciles permbushen vlerat kontraktuale te Energjise Elektrike sipas marreveshjes tregtare midis personave apo Paleve. Kjo periudhe eshte nje vlere e plote e kohes te kerkeses per Energji Elektrike.
Rryma e matjes	kupton rrymen e lejuar te matesit te perdorur me qellim matje.

Inspektim do të thote egzaminim i produktit të matjes, shërbimit, procesit ose sistemit dhe përputhshmeria e tyre me kërkesat specifike ose kërkesat e përgjithshme bazuar në gjykimin profesional.

Konsumatorët me shumicë dhe ata fundor të energjisë elektrike.

Qendra Dispecer Një division i OST e cila skedulon dhe dispeceron burimet e sistemit në mënyrë që të bëhet mbulimi i ngarkesës si dhe siguron operimin e qendrueshëm të sistemit elektroenergjitik.

Mosmarrëveshje Në kuptimin e Rregullave të Tregut dhe të Kodeve teknike janë diferenca që dalin ndërmjet OST dhe ndonjë pale tjetër për ose në lidhje me Rregullat e Tregut dhe Kodet teknike.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OST) Një person juridik përgjegjës për operimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen dhe nëse është e nevojshme zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të pëcaktuar dhe, nëse është e aplikueshme interkonjekonëktimin e tij me sistemet e tjera për të siguruar në një periudhë afat gjatë aftësinë e sistemit.

Energji Elektrike Do të thote energji elektrike dhe fuqi elektrike, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) Institucioni rregullator që operon sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror.

Klienti (Konsumatori) i Kualifikuar Një klient që ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin e energjisë elektrike për energjinë elektrike që përdor për nevojat e tij.

Klienti tarifar.
përdorim vetjak. Klienti (konsumatori) që blen energji elektrike për

Konsumatorët Fundor
përdorim vetjak Klienti (konsumatori) që blen energji elektrike për

Kalibrim tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një instrument ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga

	një masë materiale, si dhe të vlerave të njohura, korresponduese të instrumentit të matur.
Verifikim	është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.
Verifikim i rregullt i një instrumenti matës	verifikim i kryer periodikisht dhe në përputhje me rregullat.
Verifikim jashtë radhe i instrumentit matës	verifikimi i kryer pas rimodelimit, eliminimit të mosfunksionimeve ose defekteve të tjera teknike (riparim) apo i kryer jashtë periudhës së verifikimit.
Autorizim	dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vendase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.
Çertifikim	veprimtaria, nëpërmjet së cilës një palë e tretë dhe e pavarur dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në udhëzimet metodike të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, ose në përputhje me standardet e përcaktuara
Inspektim	shqyrtimi i një produkti, shërbimi, procesi ose sistemi matës, me anë të përcaktimit të përputhjes së tyre me kërkesat specifike ose në bazë të një gjykimi profesional, me kërkesa të përgjithshme
Miratim i tipit të instrumenteve matëse	pranimi i këtyre instrumenteve për verifikim fillestar dhe, kur kjo e fundit nuk kërkohet, autorizimi për t'i hedhur ato në treg dhe/ose për t'i vënë në shërbim.
Verifikim fillestar i instrumenteve matëse	kontrolli i një instrumenti të ri apo të riparuar dhe vërtetimi i përputhjes së instrumentit matës me tipin e miratuar.
Lejim për hedhje në treg ose vënie në shërbim të instrumenteve matëse	

<u>Kolaudim</u>	testim, prove, kontroll, analize. Testim i pajisjes/punës në kushte mjedisore, ka për qëllim të zvogelojë gabimet dhe t'i bejë me të vogla se të lejuarat.
<u>Remont</u>	Riparim madhor i kontatoreve apo sistemit të matjes pas verifikimit
<u>Kontator</u>	Pajisje që përdoret për të matur sasinë e energjisë elektrike që shpenzohet nga një residence, biznes apo çdo lloj objekti tjetër
Kontroll i kontatorit	percaktimi i gabimeve të tij.
38-instalim - vendosje, montim	
39-montim- mberthim, fiksim, vendosje	
40-demontim- zberthim, zhvendosje	
41-ekspertizë- vlerësim që kryet nga ekspert	
42-ekspertizë ligjore - vlerësim që kryet nga ekspert ligjor	
43-ekspertizë teknike- vlerësim që kryet nga ekspert teknik	
45-Matja është një seri veprimesh për të përcaktuar vlerën e një sasi.	
46-Pika e matjes	vendi fizik ku është realizuar lidhja dhe ku sistemi i matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas këtij Kodi.
.	
Pika e lidhjes	vendi fizik ku realizohet lidhja e Përdoruesit/Konsumatorit me Sistemin e Trasmetimit /Sistemin e Shpërndarjes.
Mates Kontrolli	matesi i autorizuar dhe i çertifikuar për kontrollin e matjes në rastet kur ka debate midis Paleve për tregimet e matjes të matesit të vendosur në objekt, ose në rastin e kontrolleve rutine të programuar të matesave.

ANEKSI 3: ÇËSH TJET TEKNIKE

Sistemi i menaxhimit të procesit të regjistrimit dhe kolaudimit të matësve elektrik.

Kontraktori do të implementojë këtë sistem i cili do të mundësojë:

- Regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të matësve në Shqipëri
- Fotografimi, dixhitalizimi e abëjtimi me kërkesat e regjistrimit të ri të aprovuar nga DPM
- Hedhjen e informacionit aktual mbi matësat dhe ekzistues.
- Regjistrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të testimit dhe kolaudimit të matësve.
- Raportimin dhe monitorimin on line të informacionit në institucionet e interesuara.

Sistemi do të përbehet nga këto module:

1. Sistemi i regjistrimit dhe menaxhimit të të dhënave
2. Aplikim në WEB raportues për subjektet të cilët do të kenë akses në kërkimin e të dhënave.

SISTEMI I REGJISTRIMIT DHE MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE

Kjo do të jetë bërthama e sistemit i cili do të jetë i organizuar në:

- Qendra e të dhënave plotësuese
- Qendra e të dhënave gjeografike dhe të lokalizimit
- Qendra e hedhjes së të dhënave të arkives
- Njësitë e testimit dhe kolaudimit
- Njësia e menaxhimit të të dhënave.

QENDRA E TË DHËNAVE PLOTËSUESE

Ketu do të ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me informacionin mbi matësat dhe shërbimet e tyre.

Keto të dhëna do të ruhen në një database qendrore RDBMS në MS-SQL në një server të aksesueshëm nga një web server me koneksion interneti dhe adresë IP reale statike. Mund të implementohet një server Backup i replikueshëm për të siguruar shërbimin në çdo kohë. Keto të dhëna do të jenë aksesibel gjithashtu nga terminalët e menaxhimit në rrjetin lokal LAN.

QENDRA E TË DHËNAVE GJEOGRAFIKE DHE TË LOKALIZIMIT

Keto jane hartat gjeografike te digitalizuara me koordinatat GIS. Keto te dhena do te ruhen ne sistemin MAPSERVER dhe do te aksesohen nga qendra e te dhenave plotesuese. Sistemi MAPSERVER mundeson importimin e hartave te digitalizuara GIS. Kjo do te mundesoje paraqitjen grafike e vizive te vendodhjes dhe lokalizimit te matesve.

QENDRA E HEDHJES SE TE DHENAVE TE ARKIVES.

Per te mundesuar menaxhimin e te gjithë matesve ne sistem duhet te hidhen informacionet e tyre nga arkiva ekzistuese. Ne varesi te trajtes dhe volumit te ketyre te dhenave mund te nevojiten nga 70 deri 100 poste operatore per DATA ENTRY.

Terminalet e kesaj qendre do te operojne me programin e zhvilluar per kete rast i cili do te mundesoje hedhje e te dhenave plotesuese dhe te lokalizimit.

Kompania CEAZ duhet te furnizojë me gjithë materialet e nevojshme per kete qellim.

Keto materiale do te fotografohen digitalizohen dhe do te hidhen nga operatorët ne sistemin e ngritur per kete qellim.

NJESITE E TESTIMIT DHE KOLAUDIMIT

Keto jane terminalët e testimit te cilet do te kryejne sherbimin ne vendodhjet e matesve.

Ne varesi te llojit te terminaleve dhe informacionit te cilet ata do te regjistrojne keta te fundit duhet te jene te pajisur me mundesi trasnmetimi te dhenash ne formen GPRS nepermjet rrjetit celular kombetar. I gjithë informacioni digital i marr nga keto njesi do te trasmetohet nepermjet protokollit TCP IP dhe do te regjistrohet nepermjet WEB servisit te zhvilluar posacerisht ne Qendren e te dhenave plotesuese.

Ne kete informacion perfshihet gjithashtu edhe informacioni mbi vendodhjen ne baze te rrjetit boteror te pozicionimit GPS.

Ne kete menyre per cdo sherbim te kryer ne matesa do te mund te merret automatikisht:

- Koordinate gjeografike e vendit ku eshte kryer sherbimi,
- Foto e pajisjet matese dhe e ambientit.
- Informacioni mbi matesin.
- Rezultatet teknike te testimit.

NJESIA E MENAXHIMIT TE TE DHENAVE

Kjo eshte pjesa administrative e procesit dhe do te jete e implementuar prane qendres se te dhenave plotesuese dhe atyre gjeografike.

Per menaxhimin e te dhenave do te zhvillohet programi (software) i cili do te mundesoje regjistrimin modifikimin dhe raportimin e ketij informacioni.

WEB SITE RAPORTUES

Nepermjet ketij sistemi do te mundesohet raportimi dhe monitorimi i te gjithë procesit tek institucionet e interesuara.

Nepermjet ketij sistemi ne WEB do te mund te kryhet:

- Kerkimi sipas kriterëve te ndryshme per cdo mates ne Shqiperi
- Kerkim sipas kriterëve te ndryshme per cdo sherbim testimi dhe kolaudimi te kryer.
- Kerkim dhe lokalizim viziv i vendodhjes se sherbimit dhe klientëve.
- Kerkim dhe raportim te informacionëve dhe rezultateve te testimit dhe kolaudimit te matesve.

Per lokalizimin dhe evidentimin e vendodhjes do te perdoren hartat digitale te GIS te cilat do te perditosen me te dhenat e nevojshme per kete qellim.

Ky web site do të mund të aksesohet nga cdo kompjuter i lidhur në internet.

Aksesimi do të mundësohet vetëm për përdoruesit e regjistruar të cilët do të pajisen me kod përdorimi dhe fjalëkalim nga administratoret e sistemit.

Nëpërmjet aplikimit web do të mund të lokalizohet nëpërmjet hartës vendodhja e matësve të caktuar.

Raportet e gjeneruara nga ky web site do të mund të printohen apo eksportohen ne formate te ndryshme.

Per te permbushur kerkesat ne lidhje me sigurine e aksesimit ky web site do te aksesohet vetem nepermjet protokollit te enkriptuar SSL.

Sipas nevojës do te leshohen certifikata SSL nga kompania ne menyre qe sistemi te aksesohet vetem nga kompjuterat e autorizuar per kete qellim.

Pershkrimi i detyrave te Arshives fizike te matesave elektrik e hartes se shperndarjes se tyre

Krijimi i database elektronik (Sistemi i Rregjistrimit te Matesit) e arshives fizike të aparateve matës të energjisë për ruajtjen e të dhënave sipas kodit të matjes;

Instalimi i sistemit elektronik për mundësimin e marrjes së të dhënave nga database e harta në kohë reale nga ERE, DPM e Kontraktuesi.

Detyra specifike:

1. Dokumentat që Kontraktori arshivon sipas akteve ligjore në fuqi,kodit te matjes e kerkesave te DPM.
2. Dokumentat e matesave do te ruhen per dhjete vjet.
3. Ne cdo rast te nderrimit te matesave e ndryshohet dhe arshiva fizike per matesat.
4. Pas dhjete vjetesh arshiva fizike e matesave ndyshon vetem me ndrrimin e matesave ose pasi te zevendesohet me dokumentacionin e ri.
5. Ne rregulloren e brendshme të Kontraktori per funksionimin dhe ruajtjen së dokumenteve të arshives e fizike te matesave eshte parashikuar se venia ne dispozicion te DPM ,ERE,CEZ ,kryhet pas kerkeses me shkrim nge keto institucione .

6. Zbaton aktet ligjore e nënligjore lidhur me sekretin e dokumentave që hyjnë në arshivë te ruajtjes se sekretit e konfincialitet,

Skema logjike e funksionimit eshte dhene ne figuren me poshte:

Ne Ilustrimi i nderfaqes se aplikimit WEB do te jene edhe keto te dhena:

Rregjister themeltar i kontatoreve te energjise elektrike te klienteve


Viti

Rrethi, Adresa

Zona


Fideri

Kabina Te dhena te kontatorit -Tipi, Nr.serial, Data e montimit, Data verifikimit fundit



Ilustrimi i nderfaqes se aplikimit WEB eshte dhene ketu

PAMJE ILUSTRUESE E NDERFAQES SE RAPORTIMIT NE WEB PER INSTITUCIONET E INTERESUARA



ANEKSI 4: TARIFAT

1 - Tarifat qe do te aplikohen per sherbimet objekt i kesaj kontrate, bazohen ne Nenin 51 pika 12 te Ligjit Nr. 9072,date 22/05/2003 "PER SEKTORIN E ENERGJISE ELEKTRIKE " te ndryshuar,shkreses se METE Nr3689,date 02/08/2010 dhe shkreses se Ministrise se Financave nr.5348,date 27/08/2010 me subjekt"Dergohet Miratim Tarifash" , si me poshte:

NR	Pershkrimi	Cmim me Tvsh
1	Sherbimi i Testimit e Verifikimit te Aparatit Mates Elektrik nje fazor (kontaktorit) ne objekt.	3,418
2	Sherbimi i Testimit e Verifikimit te Aparatit Mates Elektrik tre fazor (kontaktorit) ne objekt.	4,130
3	Sherbimi i Kolaudimit te Apratit Mates Elektrik nje fazor (kontaktorit) ne stende.	1,267
4	Sherbimi i Kolaudimit te Apratit Mates Elektrik tre fazor (kontaktorit) ne stende.	1,521
5	Sherbimi i Montimit te Aparatit Mates Elktrik (kontaktorit)	2,488
6	Sherbimi i Cmointimit te Aparatit Mates Elektrik (Kontaktorit)	367
7	Sherbimi i Vulosjes Aparatit Mates Elektrik (Kontaktorit)	233
8	Ekspertiza ligjore e gjendjes teknike ,verifikimit e koalidimit te aparateve matese elektrike(kontaktorit).	32,603

Shenime plotesuese

- a- Ne raste jo te planifikuara dhe emergjente.,sherbimi i Transportit do te kryehet me te Tretet dhe do te ngarkohet sipas cmimeve te miratuara nga Njesite Vendore
- b- Cmimet jane te shprehura ne Lek dhe perfshijne Tvsh.
- c- Cmimet e miratuara, I referohen cmimit per njesi dhe jo me pak se 4 aparate mates elektrik (kontaktor) per verifikim,koalidim ne objekt ose stende.

2 - Per sa i perket sherbimeve te tjera objekt i kesaj kontrate dhe jo te shprehura ne pasqyren e mesiperme , do te aplikohen cmimet e DPM per raste te ngjashme per sa kohe keto cmime nuk jane miratuar nga METE dhe Ministria e Financave.

Keto sherbime , te kerkuara dhe nga Neni 5 pika 1 e Ligjit nr.10362,date 16/12/2010 per disa ndryshime te Ligjit nr 9072 date 22/05/2003 "PER SEKTORIN E ENERGJISE ELEKTRIKE " dhe nga Kodi i Matjes dhe kerkesave te DPM per arshiven e matesave elektrike, deri ne miratimin e cmimeve te tyre nga organet qe cileson Ligji do aplikohen mbeshtetur ne tarifat e aplikuara per raste te ngjashme nga DPM.

3- Per sherbimet objekt i kesaj kontrate,te Ligjit nr.10362, Kodit te Matjes dhe DPM te ofruara nga Kontraktori per Shperndaresit jashte planifikimit dhe emergjente , do te aplikohen tarifat e meposhtme qe rrjedhin nga kjo analize kostoje:

- a- Pagat e Specialisteve,
- b- Transporti,
- c- Koha e pritjes,
- d- Shkalla e veshtiresise se sherbimit,
- e- Orari dhe vendodhja e ofrimit te sherbimit,
- f- Fashat orare,
- g- Detyrimet e Kodit te Punes per veshtiresite dhe shperblimet perkatese ne ditet e pushimit dhe jashte orarit,
- h- Cmimet e aprovuara,
- i- Dhe zera te tjere sipas rasteve qe do te paraqiten mbi bazen e procesverbaleve te perbashketa nga Kontraktori dhe Shperndaresi,
- j- Fitimi i shoqerise.

4 - Per sherbimet e ofruar ne laborator me kerkesen e shperndaresit ose personave fizik ose juridik te interesuar , shpenzimet e transportit dhe marrjes perballohen nga keta te fundit.

5 - Sherbimet e transportit te matesave elektrike qe nderrohen nga Kontraktori ne subjektet qe ata kontrollojne perballohen nga shoqeria.

6 - Kontraktori ,mbas njoftimit te bere shperndaresit ose personave fizik/juridik per terheqjen e matesave te kolauduar,verifikuar dhe vulosur ne laborator gezon te drejten e aplikimit te *tarifave shtese* per magazinimin dhe ruajtjen e tyre nese marrja e tyre nuk behet ne kohen e njoftuar. Keto tarifa do te jene + 2 % ne ore mbi tarifat e magainimit.

ANEKSI 5: FATURIMI -PAGESAT

1. Faturimi

1.1 Faturimi do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1.2 Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me shërbimet e realizuara secila nga Palët ka të drejte të fillojë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, siç detajohet në pikat e mëposhtme.

2. Kryerja dhe mënyra e pagesave

2.1 Të gjitha pagesat që Palët duhet të bëjnë sipas kësaj kontrate do të bëhen në adresat financiare të mëposhtme:

2.2 Pagesat do të bëhen brenda 5(pese) ditëve nga data e faturimit. Në rast vonese në pagesë, debitori detyrohet ti paguajë kreditorit një kamatë vonese të barabartë me normën e interesit bankar të shpallur nga Banka e Shqipërisë të ditës kur kryhet pagesa plus 2 % që i shtohen vlerës së faturës për t'u paguar. Shërbimi do të aktivizohet vetëm pas shlyerjes së detyrimit.

2.3 Për faturim do të zbatohet fatura tatimore duke aplikuar edhe TVSH në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Procedura për kryerjen e pagesës:

Kontraktori i drejtohet Kontraktuesit me shkrim, duke paraqitur originalin dhe kopjen së bashku me një listë të Shërbimeve të kryera për të cilat duhet paguar.

a) Pagesa e barabarte me vlerën 25% të vlerës së çdo shërbimi, i paguhet Kontraktorit nga Kontraktuesi brenda 5 diteve pune, nga dita kur Kontraktori ka rene dakort me shkrim për kryerjen e shërbimit të kerkuar;

b) Pagesa e barabarte me vlerën prej 75% të vlerës së çdo shërbimi, i paguhet Kontraktorit nga Kontraktuesi brenda 5 diteve pune, nga dita kur Kontraktori ka vertetuar me shkrim për kryerjen e të gjithë shërbimit të kerkuar;

2. Në rast se Kontraktuesi nuk pranon të kryejë pagesën e parashikuar me siper, atëherë Kontraktori i drejtohet DPM, e cila brenda 5 ditëve pune duhet të bëjë verifikimin e shërbimit të deklaruar nga Kontraktori. Neqoftesë DPM, pasi bën verifikimet e nevojshme, bindet se shërbimi është kryer, i drejtohet bankës ku është bërë Sigurimi i Kontrates nga Kontraktuesi, për të kaluar në llogarinë e Kontraktorit vlerën në lekë të shërbimit të realizuar nga Kontraktori.

Në qoftë se vlera në Bankë, për sigurimin e shërbimit është e pamjaftueshme për të kryer pagesën, DPM, vepron në përputhje me kompetencat që i jep ligja për keto Raste.

3. Ruajtja e të dhënave

Palet janë të detyruara të ruajnë të gjitha të dhënat mbi bazën e të cilave janë bërë faturimet, për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e faturimit.

ANEKSI 6: KARAKTERISTIKAT E MATËSVE

KËRKESA TE VEÇANTA

39.1. Saktësia

Fabrikuesi duhet të specifikojë treguesin e klasës së matesit. Treguesit e klasave përcaktohen si: Klasa, A, B dhe C.

39.2. Kushtet e vlerësuara të funksionimit

Fabrikuesi duhet të specifikojë kushtet e rendit të funksionimit për matesin, veçanërisht:

Vlerat e f_n , U_n , I_n , I_{st} , I_{min} , I_{tr} dhe I_{max} që zbatohen për kontatorin. Për vlerat referuese të rrymes, matesi duhet të përmbushë kushtet e dhëna në Tabelën 1;

Tabela 1

	Klasa A	Klasa B	Klasa C
Për kontatorët e lidhur drejtperdrejte			
I_{st}	$\leq 0,05 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$
I_{min}	$\leq 0,5 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,5 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,3 \cdot I_{tr}$
I_{max}	$\geq 50 \cdot I_{tr}$	$\geq 50 \cdot I_{tr}$	$\geq 50 \cdot I_{tr}$
Për kontatorët që lidhen me transformatorë			
I_{st}	$\leq 0,06 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,04 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,02 \cdot I_{tr}$
I_{min}	$\leq 0,4 \cdot I_{tr}$	$\leq 0,2 \cdot I_{tr}^{(1)}$	$\leq 0,2 \cdot I_{tr}$
I_n	$= 20 \cdot I_{tr}$	$= 20 \cdot I_{tr}$	$= 20 \cdot I_{tr}$
I_{max}	$\geq 1,2 \cdot I_n$	$\geq 1,2 \cdot I_n$	$\geq 1,2 \cdot I_n$
(1) Për Klasën B për matesat elektromekanikë duhet të zbatohet $I_{min} \leq 0,4 \cdot I_{tr}$			

Diapazonet e tensionit, frekuencës dhe faktorit të fuqisë, brenda të cilave matesi duhet të përmbushë kërkesat e GML-së specifikohen në Tabelën 2. Këto diapazone duhet të perputhen me karakteristikat tipike të energjisë elektrike të furnizuar nëpërmjet sistemeve publikë të shpërndarjes.

Diapazonet e tensionit dhe të frekuencës duhet të jenë të paktën:

$$0,9 \cdot U_n \leq U \leq 1,1 \cdot U_n$$

$$0,98 \cdot f_n \leq f \leq 1,02 \cdot f_n$$

Ndërsa diapazoni i koeficientit të fuqisë nga të paktën $\cos\phi$ induktive = 0,5 deri në $\cos\phi$ kapacitive = 0,8.

39.3. Gabimet Maksimale të Lejuara (GML)

Ndikimet e madhësive matese dhe influencuese (a , b , c , ...) vlerësohen seicila me vete. Të gjitha madhësitë e tjera të matjeve dhe influencuese që ndikojnë në matje mbahen relativisht konstante në vlerat e tyre të referencës. Gabimi i matjes, i cili nuk duhet të kapërcejë GML-në e deklaruar në Tabelën 2, llogaritet si:

Gabimi i matjes $= (a^2 + b^2 + c^2 \dots)^{1/2}$

Kur matesi punon ne rryma me ngarkesa te ndryshueshme, gabimet në përqindje nuk duhet të kapërcejnë kufijtë e dhënë në Tabelën 2.

Tabela 2

GML-të në përqindje në kushtet e vlerësuara të funksionimit dhe nivelet e përcaktuara të rrymës

së ngarkesës dhe temperatura e funksionimit

Temperaturat e punes				Temperaturat e punes			Temperaturat e punes			Temperaturat e punes		
	+ 5°C... +30 °C			-10 °C.... + 5°C ose +30 °C .. +40 °C			- 25°C... - 10 °C ose + 40 °C .. + 55 °C			- 40 °C.... - 25 °C ose + 55 °C .. + 70 °C		
klasa	A	B	C	A	B	C	A	B	C	A	B	C
matesi nje fazor: matesi shume fazor me ngarkese simetrike												
$I_{min} \leq I < I_{tr}$	3.5	2	1	5	2.5	1.3	7	3.5	1.7	9	4	2
$I_{tr} \leq I \leq I_{max}$	3.5	2	0.7	4.5	2.5	1	7	3.5	1.3	9	4	1.5
matesi shumëfazor me ngarkesë në nje faze të vetme												
$I_{tr} \leq I \leq I_{max}$ shih përjashtimi n më poshtë	4	2.5	1	5	3	1.3	7	4	1.7	9	4.5	2
Per matesat elektromekanik shumefazor, diapazoni i rrymes per ngarkesen nje fazore kufizohet në $5I_{tr} \leq I \leq I_{max}$												

Kur një kontator punon në regjime temperature të ndryshme duhet të zbatohen vlerat e mesiperme të GML-ve.

Matesi nuk duhet te lejoje ne GML-te shfaqje sistematike ne favor te asnje ane.

39.4. Ndikimi i lejuar nga cregullimet

39.4.1. Të përgjithshme

Meqenëse matesat elektrike te fuqise janë të lidhur drejtpërdrejt me furnizimin kryesore dhe se rryma është gjithashtu një prej madhesive të matura, për matesat elektrike përdoret një mjedis elektromagnetik i veçantë.

Matesi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mjedisit elektromagnetik E2 dhe kërkesat shtesë në 39.4.2 dhe 39.4.3.

Mjedisi elektromagnetik dhe ndikimet e lejuara pasqyrojnë gjendjen kur ka crregullime me kohezgjatje të madhe të cilat nuk duhet të ndikojnë në saktësinë përtej vlerave kritike të ndryshimit dhe të crregullimeve kalimtare, të cilat mund të shkaktojnë një renie të përkohshme ose humbje të funksionit ose të performances por nga e cila gjendje matesi duhet të rikthehet dhe nuk duhet të ndikohet në saktësinë përtej vlerave kritike të ndryshimit.

Karakteristikat metrologjike të matesit duhet të mbrohen kur ekziston një rrezik i lartë i parashikueshëm për shkak të vetëtimave ose atje ku rrjetet ajrorë të furnizimit janë mbizotëruese.

39.4.2. Ndikimi i crregullimeve me zgjatshmeri te madhe

Tabela 3

Vlerat e ndryshimit kritik për crregullimet me kohezgjatje te madhe

Crregullimi	Vlerat e ndryshimit kritik në përqindje sipas klasës se matesit		
	A	B	C
Renditja e kundert e fazave	1,5	1,5	0,3
Tension josimetrik (i zbatueshëm vetëm për matesat me shumë faza	4	2	1
Përmbajtja e harmonikave në qarqet e rrymes(1)	1	0,8	0,5
DC dhe harmonikat në qarkun e rrymes(1)	6	3	1,5
Procese të shpejta kalimtare	6	4	2
Fushat magnetike: Fusha elektromagnetike HF (rrezatimi RF):Crregullime te shkaktuara nga fusha e radio-frekuencës; dhe valët lëkundëse te imunizuara	3	2	1
(1) Në rastin e matsave (kontatorëve)elektromagnetikët, nuk përcaktohet asnjë vlerë e ndryshimit kritik per permbajtjen e harmonikave ne qarqet e rrymes dhe për DC dhe per harmonikat në qarkun e rrymes.			

39.4.3. Ndikimi i lejueshëm i fenomenit elektromagnetik kalimtar

39.4.3.1. Ndikimi i një crregullimi elektromagnetik në një mates të fuqise elektrike duhet të jetë i tillë që gjate dhe menjëherë pas crregullimit

- çdo informacion i parashikuar me synim për të testuar saktësinë e matesit nuk prodhon impulse ose sinjale që i korrespondojnë një fuqie më të lartë sesa vlera kritike e ndryshimit dhe në një kohë të arsyeshme pas crregullimi matesi duhet
- të rifillojë të funksionojë brenda kufijve të GML-së, dhe
- të ketë të mbrojtura të gjitha funksionet e matjes , dhe
- të lejojë rikthimin e të gjitha të dhënave të matjes përpara crregullimit, dhe

- e. nuk duhet të shenoje një ndryshim në fuqinë e regjistruar prej më shumë sesa vlera e ndryshimit kritik.

Vlera e ndryshimit kritik në kWh është $m \cdot U_n \cdot I_{\max} \cdot 10^{-6}$

(m është numri i elementeve matës të matesit, U_n në volt dhe $I_{\max}$ në amperë).

39.4.3.2. Për mbingarkesë vlera kritike e ndryshimit është 1,5 %.

39.5. Përshtatshmëria

39.5.1. Nën voltazhin e regjimit të punës gabimi pozitiv i matesit nuk duhet të kapërcejë 10 %.

39.5.2. Displei energjise totale duhet të ketë një numër të mjaftueshëm shifrash për të siguruar se kur kontatori funksionon për 4 000 orë me ngarkesë të plotë ($I = I_{\max}$, $U = U_n$ dhe $PF = 1$), treguesi nuk rikthehet në vlerën fillestare të tij dhe nuk do të jetë në gjendje të zerohet gjatë përdorimit.

39.5.3. Në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike në rrjet, sasi të e matura të energjisë elektrike duhet të

mbeten të vlefshme për t'u lexuar gjatë një periudhe të paktën për 4 muaj.

39.5.4. Funksionimi pa ngarkesë

Kur qarku i tensionit është i kycur, ndersa ai i rrymes është i hapur, matesi nuk duhet të regjistrojë energji për asnjë vlerë të tensionit midis $0,8 \cdot U_n$ dhe $1,1 U_n$.

39.5.5. Fillimi

Matesi duhet të fillojë të punojë dhe duhet të vazhdojë të regjistrojë për tensionin U_n , $PF = 1$ (për matesat shumëfazor me ngarkesa simetrike) dhe për një rrymë e cila është e barabartë me I_{st} .

39.6. Njësitë

Energjia elektrike e matur duhet të shfaqet në kilovat-orë ose në megavat-orë.

Vendosja në përdorim

(a) Kur Autoriteti kompetent imponon matjet në përdorimin rezidencial, ai duhet të lejojë që matjet të kryhen me matesa të Klasës A. Për qëllime të caktuara autoriteti kompetent mund të kërkojë vendosjen e çdo matesi të Klasës B

(b) Kur Autoriteti kompetent i vendit imponon matjet në përdorimin në tregëti dhe/ose në industrinë e lehtë, ai duhet të lejojë të kryhen matjet nga çdo matesi i Klasës B. Për qëllime të caktuara ai autorizohet të kërkojë çdo matesi të Klasës C.

(c) Autoriteti kompetent duhet të sigurojë që regjimi i rrymes i përcaktuar nga distributori ose personi i autorizuar ligjërisht për instalimin e matesit, është i tillë që matesi të jetë i përshtatshëm për matjen e saktë të konsumit që është i parashikuar ose i parashikueshëm.

1-Shpërndareshi menaxhon aparatet matëse elektrike

1.1-Shpërndareshi zbaton me rigozitet të korrektesë Kodin e Matjes dhe kërkesat e DPM-se të cilat përcaktojnë kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes të Energjisë Elektrike, që do të jetë i përshtatshëm për matje, për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave perkatese sipas rregullave të tregut dhe marrëveshjeve midis Paleve.

1.2- Paisjet matese qe sigurohen nga te gjithë pjesëmarresit e tregut detyrohen nga legjislacioni ne fuqi te jene te rregjistruara ne Sistemin e Rregjistrimit te Matesave (SRM) , ne perputhje me termat e Kodit te Matjes si dhe ne perputhje me ligjin Nr.8996 date 30.01.2003 “Per njesite e matjes dhe kontrollin e mjeteve matese (metrologjine)”, si dhe ligjin Nr 10362 per energjine i ndryshuar.

1.3-Te dhenat do te permbajne te pakten keto specifikime per sistemet e matjes dhe matesat per çdo pike matje::

- Specifikimet teknike te matesit
- Numrin serial
- Numrin e thirrjes (per matesat me kontrollin ne distance)
- Vleren e impulseve mates
- Te dhena te transformatoreve te matjes (transformatore rryme, transformatore tensioni)
- Çertifikatat e paisjeve te sistemit te matjes (per ato qe jane)
- Piken e lidhjes/adresen e objektit ku eshte lidhur matesi
- Numri ID (identifikues) i konsumatorit(Perdoruesit)
- Numri ID (identifikues) i furnizuesit
- Data e instalimit
- Testet e kontrollit
- Teste te ndryshme sipas kerkesave etj.

1.4- SRM do te kete te rregjistruar deri ne ditën aktuale çdo ndryshim te perdoruesve dhe konsumatoreve, te paisjeve matese dhe çdo shkeputje te lidhjeve te tyre. Çdo informacion tjeter ne lidhje me çdo pike matjeje qe mund te kerkohet nga pjesëmarresit e tregut duhet te jete i rregjistruar ne SRM.

1.5-Te dhenat e SRM do te jene te vlefshme per subjektet apo persona fizik e juridik sipas kerkeses te tyre dhe sipas formatit te percaktuar nga DPM.

1.6 -Keto kerkesa teknike dhe kushte mund te rishikohen here pas here nga DPM dhe miratohen nga ERE, me qellim qe te merret ne konsiderate çdo ndryshim i teknologjise apo kerkesave teknike qe lidhen me zhvillimin industrial si dhe udhezimet nderkombetare.

1.7-Matesat duhet te jene te instaluar ne nje kuti (boks individual) ose kabinet (boks kolektiv ose panel). Kutia ose kabineti duhet te jete i tille qe te mbroje matesin nga lageshtira, papastertia, fushat elektromagnetike, goditjet fizike dhe te ruaje nje temeperature te pershtatshme. Kutia ose kabineti duhet te jete i siguruar me dryn dhe/ose i vulosur, me qellim qe te mos lejoje nderhyrjet e pa autorizuar..

1.8-Matesat ne perputhje me IEC ose IEC 61036 (ose standartin europian ekuivalent) do te jene te lidhur me transformatoret e rrymes dhe te tensionit.

DRAFT

ANEKSI 7: PLANIZIMI I SHËRBIMEVE TE KONTROLLIT

Të përgjithshme

Per te siguruar funksionimin e rregullt te matesave dhe sigurimin pa nderprerje te sherbimit periodik ose per cfardo defekti tjeter, palet do te bashkepunojne per shfrytezimin dhe mirembajtjen sipas kushteve te Marreveshjes ne pergjithesi, dhe ne menyre specifike te ketij Aneksi.

Shërbimet jepen në mjediset e Kontraktorit, në Tiranë dhe në vende të tjera të kësaj shoqërie, si dhe mjediset e subjekteve ne te cilat jane apo do te instalohen matesit.

Per kete qellim dalin Pergjegjesite e paleve si:

Njoftimi ne rastin e problemeve te rendesishme te cilat ndikojne zbatimin e detyrave qe rrjedhin nga ligji e kontrata, Palet duhet te njoftojne njera-tjetren ne menyren e duhur.

Palet kryejne veprimtarine e Punimet te planifikuara per te shmangur incidentet e defektet e mundeshme qe munde te lindin gjate kryerjes se sherbimit te verifikimit, kolaudimit vulosjes e kontrollit periodik te matesave elektrik.

Personat e kontaktit

Per te realizuar Marreveshjen dhe per mbarevajtjen e saj, secila Pale do te caktojte nga nje perfaqesues dhe do tja njoftojte ate Pales tjeter si person kontakti.

Personat e kontaktit se bashku do te mbikqyrin zbatimin ne vijueshmeri te kesaj Marreveshjeje. Secili prej tyre do te koordinoje punen me tjetrin dhe do ti raportojte Pales qe e ka caktuar, per cdo problem qe nuk ka gjetur zgjidhje. Me marrjen e ketij raporti Palet duhet te konsultohen me njera-tjetren me qellim qe te arrijne nje zgjidhje te pranueshme per te dy Palet.

Ne raste te ankesave per defekt teknik pikat e kontaktit te Paleve jane:

Kontraktori :

Kontraktuesi :

5. **Mbrojtja e sistemeve**

Secila Pale nuk do te kryeje dhe nuk do te lejoje qe te kryhen veprime ne Sistemin e saj, te cilat do t'i shkaktonin dem Pales tjeter, pervec rasteve kur kjo lejohet sipas kesaj Kontrate.

6. **Siguria**

Palet do te marrin te gjitha masat e nevojshme ne menyre qe te sigurojne qe zbatimi i kesaj Kontrate nuk do te rrezikojte shendetin dhe sigurine e jetes te gjitha personave, duke perfshire te punesuarit dhe perdoruesit e njera-tjetres. Secila Pale eshte pergjegjese per nje funksionim te sigurte pa rrezik per shendetin dhe jeten e njerezve te pajisjeve brenda Sistemit te saj, ne anen e saj te pikes se _____.

7. **Bashkëpunimi**

Palët do te bashkëpunojnë në kryerjen e veprimeve te pranueshme reciprokisht, per testimin dhe eliminimin e incidenteve e problemeve te shfaqura, te cilat ndikojne ne realizimin dhe funksionimin e qellimit te kontratës.

8. Palët bashkërendojnë aktivitetin e tyre organizativo – teknik për realizimin praktik të objektit të kontratës. Këtij qëllimi i shërbejnë strukturat respektive përkatëse që duhet të krijohen posaçërisht për këtë qëllim. Palet mbajnë përgjegjësi reciproke per zbatimin ne kohe e cilesi i ketij programi

9. Ne rastet kur gjate zbatimit ne praktike te kesaj kontrate lind nevoja e domosdoshme per te bere ndonje ndryshim apo shtesë, atëherë ajo eshte e mundshme vetem mbasi te dy palet te kene rene dakord me shkrim.

10. Kontraktori, konform kerkesave te standarteve te matjes, eshte i detyruar te evidentojte sakte te gjitha te dhenat qe rezultojne nga aktiviteti i matjes se kryer ne zbatim te objektit te kesaj kontrate. Mbas perfundimit te Sherbimit te Kontrollit ne objekt, kontraktori me nje akt dorezimi te veçantë duhet t'i dorezoje Kontraktuesit nje kopje te plote me rezultatet e matjeve te kryera dhe konkluzionet perkatese. Te dy palet jane te detyruara te administrojne, arshivojne dhe ta ruajne kete dokumentacion per nje periudhe te caktuar. Kontraktori duhet te krijojte arkiven fizike dhe regjistrimin elektronik sipas standarteve te legjislacionit ne fuqi.

11. Secila palë merr përsipër që të mos bëjë ndryshime në rrjet, ose çdo pajisje që përfshihet në të, si dhe te çdo komande ose protokoll që ruhet, ndryshim i cili mund të ndikojë ose dëmtojë funksionimin e pajisjeve të palës tjetër. Çdo ndërhyrje e njëanshme për të bërë ndonjë ndryshim në rrjetin e skemën e matjes pa iu komunikuar paraprakisht palës tjetër do të konsiderohet si shkelje e rende e dispozitave të kësaj kontrate.
12. Secila palë do të sigurojë vazhdimësinë e marrëdhënies ndërmjet tyre, duke u bazuar në parimin e korrektesës në përmbushjen e detyrimeve respektive.
13. Kontraktuesi, pronar i matësve të energjisë dhe sistemit të tij matës mban përgjegjësinë për instalimin dhe shfrytëzimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike të shfrytëzimit të mjeteve matëse të përcaktuara nga rregulloret në fuqi.
14. Kontraktuesi është i detyruar të njoftojë paraprakisht dhe në vazhdim Kontraktorin mbi mundësinë e blerjes së matësve të rinj në mënyrë që të sigurohet kontrolli, prova e tyre në kohë e cilësi nga ana e Kontraktorit.
15. Kontraktuesi është i detyruar të garantojë dhe të sigurojë dhënien e saktë dhe në kohë të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm që i shërben Kontraktorit për të realizuar në kohë e cilësi objektin e kësaj kontrate.
16. Kontraktuesi është i detyruar të garantojë kushtet normale organizative e teknike për punë të grupeve të punës në terren për verifikimin, kolaudimin e vulosjen e pajisjeve matëse elektrike.
17. Kontraktori është i detyruar që para fillimit të Shërbimit të Kontrollit në një objekt, t'i paraqesë për verifikim dhe miratim Kontraktuesit programin e detajuar organizativo - teknik të punës për realizimin e këtij procesi. Fillon zbatimin e tij vetëm mbasi ai ka marrë miratimin me shkrim nga kontraktuesi.
18. Për fillimin e punimeve, zhvillimin dhe mbylljen e shërbimeve të verifikimit, kolaudimit, vulosjes para përdorimit, si dhe gjatë kontrollit e inspektimit periodik të cilat duhet të bëhen në prezencën mbi këqyrëse të stafit teknik përgjegjes të shpërndaresit, kontraktuesi duhet të realizojë me rigorozitete detyrat që rrjedhin nga kërkesat e ligjit si:
 - a. Shpërndaresi miremban mjediset dhe rrjetin e ushqimit të paisjeve matëse në përputhje me kërkesat teknike.

- b. Zhvillon paisjet matese elektrike, ne perputhje me perspektivat e zhvillimit dhe te ndryshimit te kerkeses per energji elektrike e sherbime te tjera nga klientet dhe perdoruesit, te nevojshme per te permbushur detyrimet e tyre, sipas legjislacionit ne fuqi dhe njofton kontraktorin DPM e ERE per cdo ndryshim.
- c. Te gjithë elementet e lidhur direkt me paisjet matese do ti sigurojne shperndaresi.
- d. Shperndaresi duhet te jap urdhera per koordinimin dhe manovrimin ne Sistemin e Shperndarjes sipas rregullave ne fuqi per sigurine e ruajtjen e personelit te sherbimit te Kontraktori te cilet do te kryejne procedurat sipas normave teknike specifike dhe rregullave per testimin e paisjeve matese e sigurise ne pune.
- e. Shperndaresi eshte i detyruar te marre te gjithë masat e nevojshme per kufizimin e perhapjes se avarive dhe per te ruajtur punen normal ne rast te një gjendje te paqendrueshme veprimi te ekipit testues te Kontraktorit.
- f. Ne rrethanat kur gjate punes te testimit rrjeti shperndares bie ne gjendje avari Kontraktori nderpret veprimet dhe harton një proces- verbal ne te cilin pasqyrohen shkaqet e nderprerjes se punes .Ky proces-verbal bashkefirmoset nga perfaqesuesi i shperndaresit.
- g. Kontraktori e Shperndaresi do te shkembejne raporte me shkrim ose ne forme elektronike, sipas rastit. Raporti do permbaje njoftimin me më shume detaje lidhur me planifikimin e punes, incidentet ose difektet, duke perfshire edhe informacionet qe jane bere te njohura per incidentin ose difektin pas njoftimit.
- h. Aty ku eshte deklaruar një incident ose difekt dhe eshte paraqitur një raport, Kontraktori ose Shperndaresi mund te kerkojne me shkrim qe te kryhet një hetim i perbashket. Nje grup hetimi do te jete i nevojshem per incidentin ose difektin qe do hetohet dhe do vendoset nga gjithë palet e perfshira. Nje hetim i perbashket do te zhvillohet nga gjithë palet e prekura qe bien dakord. Format, rregullat, procedurat dhe te gjitha çeshtjet lidhur me hetimin e perbashket do te vendosen ne mareveshjen e hetimit te perbashket. Ne mungese te marreveshjes hetimi i perbashket nuk do te zhvillohet, por do te zhvillohet hetimi nga organet e ngarkuara nga ligji,DPM e ERE.
- i. Çeshtjet ne raportin e shkruar per incidentin e rendesishem duhet te perfshijne:
 - Daten dhe oren e Incidentit te Rendesishem;
 - Vendin;

- Pajisjet e perfshira;
- Pershkrimin e shkurter te Incidentit, demet e shkaktuara;
- Detaje te çdo veprimi te ndermarre;
- Periudhen e nderprerjes se punes;
- Konkluzione dhe rekomandime nese aplikohen;
- Kohezgjatja e incidentit;
- Data e parashikuar dhe koha e rikthimit ne sherbim normal

Planifikimi i veprimtarise per inspektimin, testimin, kolaudimin, regjistrimin e vulosjen e paisjeve matese elektrike

1. Kontraktori dhe operatori shperndares planifikojne punen per zhvillimin me sukses e korektesi te krijimit te regjistrit te paisjeve matese elektrike, inspektimit periodik, testimit, kolaudimit e vulosjes se matesave elektrik.
2. Planifikimi i zhvillimit te Sistemit te Shperndarjes ka qellimet e meposhtme:
 - 1.1. Te mundesoje planifikimin, projektimin, dhe ndertimin e rrjet operimit te shperndaresit me Kontraktorin, per te operuar ne menyre ekonomike dhe te sigurte.
 - 1.2. Te mundesoje krijimin e aksesit ne perdorimin e rrjetit te Shperndarjes duke krijuar hapesirat funksionale per ushtimin me sukses te detyrave nga Kontraktori.
 - 1.3. Te siguroje informacion te mjaftueshem per Kontraktorin per te vleresuar mundesite per kontrollin periodik te aparateve matese elektrike dhe per te planifikuar dhe zhvilluar sondazhe per mirfunksionimin e procedurave te verifikim, kolaudimit e vulosjes te paisjeve matese elektrike.
 - 1.4. Te formalizoje kerkesat e te dhenave per planifikimin e kontrollit periodik :
 - 1.4.1. Informacion te pergjithshem mbi gjendjen e tyre fizike e teknike
 - 1.4.2. Harten e rrjetit te vendosjes se matesave elektrik
 - 1.4.3. Klasifikimin e tyre sipas fuqise, kohes me te afert te verifikimit e regjistrimit te te dhenave.

1.4.4. Adresarin e matesave elektrik dhe personat e kontaktik per zona te caktuara si perfaqesues te autorizuar te shperndaresit.

1.5. Te njohe me planifikimin e zhvillimit te sistemit te matjeve veprimet operacinale te shperndaresit te cilat kushtezojne harmonizimin e punes me Kontraktorin per realizimin e detyrave te regjistrimit,verifikimit,kolaudimit e vulosjes te matesave periodik para se te fillojne punen.

1.6. Te krijoje nje strukture permanente, (Nje departament planifikimi operacional dhe programimi operativ), qe kryen planifikimin, operimin dhe analizat e operimit si, dhe perpunimin e te dhenave specifik me Kontraktorin transferimin e te dhenave te matesave e per planifikimin e zbatimin e procesit te inspektimit,verifikimit,kontrollit periodik kolaudimit e vulosjes se matesave elektrik

1.7. Me qellim qe te lehtesohen lidhjet e reja / modifikimet e lidhjeve egzistuese me matesat Shperndaresi planifikon se bashku punen me Kontraktorin.

Departamenti planifikimit operacional per lidhjet e reja

1. Strukturat e ekzekutimit të lidhjeve të reja në kompaninë shpërndarëse , duhet në fund të muajit të paraqesë në shkallë kombëtare ose zonale,numrin e lidhjeve të reja per tension te larte e cdo jave per tension te ulët , vendin (qytet ose fshat) me adresë të saktë te konsumatorit dhe të bashkëveprojë punën për ekzekutimin e lidhjeve të reja në pjesë të ndryshme të sistemit të shpërndarjes
